



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË

Nr 24 prot  
datë 10.06.2026



VENDIM

Nr. 18, datë 09.06.2026

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR  
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT  
“NZI” SH.P.K, ME VENDNDODHJE:TRUSH, NJËSIA  
ADMINISTRATIVE BËRDICË, BASHKIA SHKODËR.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uJOR, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi uJOR nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “NZI” sh.p.k., me vendndodhje: Trush, Nj.Adm Bërdicë, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit uJOR (pus-shpimi):

- X= 456613
- Y= 4649562
- Z= 5 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim :  $Q = 0.3$  l/sek

- Qëllimi i përdorimit: Për përdorim teknologjik (Baxho).
- Thellësia e pus-shpimit: 10.3 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 9.3 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (Pusetë dekantuese):

X= 456624;                      Y= 4649585;                      Z= 4 m –

Prurja që shkarkohet: Q= 0.25 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBL DRIN-BUNË**



**HOLTA DUDA**